



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 4/1 Prot.

Tiranë, më 6/9/2010

Lënda: Rekomandim lidhur me inspektimin administrativ të datës 04/08/2010.

Drejtuar: Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit

Adresa: Porti i Durrësit

DURRËS

Më datë 04/08/2010 nga grupi i inspektimit të zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë jush, me cilësinë si kontrollues që mblidhni dhe përpunoni të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit tuaj, me objekt:

- A njihet ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, dhe ç’masa janë marrë për implementimin e tij.
- Për këto të dhëna a zbatohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Ç’masa merren për sigurinë e të dhënave personale. Ku mbahen të dhënat dhe sa është koha e mbajtjes së tyre.
- Nëse kanë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose rregulla që janë përfshirë në Rregulloren e Brendshme.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale.
- Nëse ka instalime të kamerave të fshehta, si përdoren ato dhe a ka paralajmërime për përdorimin e tyre.
- Nëse e njohin detyrimin për të njoftuar të dhënat personale që përpunojnë, në ç’shikullë dhe si veprohet.
- Nëse dhe në ç’masë zbatohen rregullat e konfidencialitetit për përpunimin e të dhënave personale.

Nga konstatimet e bëra gjatë inspektimit administrativ rezultoi se, nga ana juaj njihet ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe respektohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të tij, lidhur me të dhënat personale që ju grumbulloni dhe përpunoni në funksion të qëllimit të punës tuaj.

Komisioneri konstaton se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale nga ana e juaj bëhet konform ligjeve organike dhe specifike me të cilat ju operoni, ligjit nr. 9749 datë 4.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", ligjit nr. 9861 datë 24.01.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror" dhe ligji nr. 9959 datë 17.07.2008 "Për të huajt", duke garantuar dhe respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtën e jetës private konform ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"

Si një kontrollues me status të veçantë (pjesë organike e strukturës së Policisë së Shtetit) masat e marra nga ju për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale janë konform kushteve dhe kërkesave të ligjit 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi aktet e inspektimit administrativ (relacionin, procesverbalin e konstatimit etj) të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara konstaton:

Kontrolluesi Drejtoria Rajonale e Kufirit dhe Migracionit Durrës nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

- Në këtë rast nuk është zbatuar neni 21 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

Mbështetur në nenet 29 dhe 30 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" Komisioneri rekomandon:

Të merren masat e nevojshme për plotësimin e formularit lidhur me njoftimin pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke respektuar kërkesat e nenit 21 të ligjit nr. 9887 dt. 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Kryerja e këtij rekomandime të rëndësishëm për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda datës 10 Shtator 2010.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

